



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 09.05.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Erion Braçe – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit,
2. Raporti vjetor i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për vitin 2017.

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Anastas Angjeli, Antoneta Dhima, Ervin Bushati, Evis Kushi, Ilir Xhakolli, Roland Xhelilaj, Arben Pëllumbi, Xhevit Bushaj, Ismet Beqiraj dhe Edmond Haxhinasto.

Mungojnë:

Blerina Gjylameti, Jorida Tabaku, Edmond Spaho, Dashamir Shehi, Fatbardha Kadiu, Agron Shehaj, Nadire Meçorapaj, Reme Lala dhe Përparim Spahiu.

Të ftuar:

Ervin Koçi - Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së

Pajtim Melani - Kryetar i Bordit të AMF-së

Lyela Rama – Drejtor i Departamentit të Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve

Violanda Theodhori – Drejtore e Departamentit Juridik në AMF

Niko Kotonika – Drejtor i Departamentit të Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve

HAPET MBLEDHJA

Erion Braçe – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Të hyjnë mediet!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Ekonominë dhe Financat. Siç jeni njoftuar në rendin e ditës së sotme të punës të komisionit kemi shqyrtimin e raportit vjetor të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për vitin 2017.

Për këtë arsye, ndodhen në komision kryetari i Bordit të AMF-së, zoti Pajtim Melani, drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, zoti Ervin Koçi dhe personat e tjerë drejtues në këtë institucion.

Relatore e komisionit për raportin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për vitin 2017 është zonja Evis Kushi. Do të procedojmë me prezantimin e raportit nga drejtuesit e AMF-së dhe më tej me relacionin e relatores së komisionit lidhur me këtë çështje.

Fjala për ju për të bërë prezantimin tuaj!

Pajtim Melani - Mirëmëngjesi!

Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Në cilësinë e kryetarit të Bordit të AMF-së po ju paraqes shkurt disa nga zhvillimet kryesore për sa i përket vendimmarrjes kryesore të Bordit për vitin 2017, nisur nga zbatimi i ligjeve dhe i të gjithë kuadrit nënligjor që mbikëqyr dhe rregullon AMF. Tregjet financiare nën mbikëqyrjen dhe rregullimin e AMF-së gjatë vitit 2017 shënuan rritjen më të madhe vjetore krahasuar me tregjet e tjera dhe krahasuar me rritjen ekonomike. Kështu, është rritur me 5,3 për qind tregu i sigurimeve, me 11,14% është rritja vjetore e tregut të fondeve të investimeve dhe 31 % është rritja vjetore e tregut të fondeve të pensioneve private.

Në total tregu i fondeve të investimeve ka 72,72 miliardë lekë asete ose 553 milionë euro.

Tregu i sigurimeve ka rreth 16,2 miliardë lekë xhiro vjetore ose 125 milionë euro, ndërsa tregu i pensioneve private ka 1,73 miliardë lekë asete ose rreth 13 milionë euro.

Në zhvillimet kryesore për sa i përket vendimmarrjes së bordit do të veçoja:

Licensimin e shoqërisë së parë me kapital privat "Bursa Shqiptare e Titujve, ALSE" me vendimin nr. 88, datë 03.07.2017. Pas testeve në muajt e parë të këtij viti dhe pas korrelacionit me sistemin AFISaR të BSH-së, ka filluar veprimtarinë në shkurt të këtij viti me fillimin e transaksioneve të para.

Siç jeni në dijeni bursa do të fillojë vetëm për tregtimin e letrave me vlerë të qeverisë dhe më pas, do të shikohet në vijim në varësi të ecurisë për licencimin e tregtimit aksioneve të shoqërive private.

I dyti, është përfundimi sagës së fondit të kompensimit me vendimin nr. 217, datë 28.12.2017, duke zgjidhur situatën e Fondit të Kompensimit, si për pagesat e menjëhershme për praktikat e përfunduara, ashtu dhe evidentimin e detyrimeve të këtij fondi.

E treta, është hartimi strategjisë 5-vjeçare të zhvillimit të tregjeve nën mbikëqyrje, sipas parashikimit të ligjit. Me propozimin e kryetarit të Bordit u mor vendimi nr. 84 datë 19.06.2017 për ngritjen e Komitetit Këshillimor me një grup ekspertësh për hartimin e strategjisë, e cila brenda 5 vjetësh do të japë drejtimet kryesore të zhvillimit të tregjeve.

Duhet thënë se norma e lartë e zhvillimit të këtyre tregjeve nën mbikëqyrjen e AMF-së tregon se ka shumë mundësi dhe shumë kapacitet për rritjen e këtyre tregjeve dhe për zhvillimin e të gjithë sistemit financiar jobankar në funksion të rritjes dhe të zhvillimit ekonomik. Rritja e besimit të konsumatorit dhe e investitorëve të tregjet financiare i takon vendimit nr. 128, datë 31.08.2017, i cili synon rritjen e edukimit financiar për zhvillimin e tregjeve dhe mbrojtjen e konsumatorëve.

Në total janë marrë 221 vendime nga të cilët 36 vendime janë marrë për masa administrative dhe korrigjuese ndaj subjekteve të mbikëqyrura dhe 39 vendime që kanë plotësuar kuadrin rregullator.

Për fondet e investimeve Bordi i AMF-së miratoi ndryshime në Rregulloren me vendimin nr. 128, datë 06.10.2011 “Mbi procedurat dhe kërkesat shtesë për licencimin e depozitarit të sipërmarrjeve të investimeve kolektive”, duke hequr komisionet apo pagesat e ngjashme shtesë që bankat depozitare ngarkonin ndaj investitorëve të fondeve të investimeve.

Po ashtu Bordi i AMF-së miratoi ndryshime në Rregulloren nr. 97, datë 25.06.2014 “Për informacionin kryesor që duhet t’i vihet në dispozicion investitorëve të skemave të investimeve kolektive”, për transparencën që fondi i investimeve vë në dispozicion të investitorëve për të shmangur asimetrinë, që ka ekzistuar më parë në këtë treg.

Në tregun e kapitaleve, siç e thamë, është licencuar bursa. Bordi i AMF-së me vendimin nr. 88, datë 03.07.2017, licenoi shoqërinë e parë me kapital privat “Bursa Shqiptare e Titujve, ALSE” sh.a.

Gjatë vitit 2017, Bordi i AMF-së ka vendosur sanksione me gjobë ndaj administratorit të një shoqërie në tregun e letrave me vlerë.

Bordi i AMF-së, me vendimin nr. 81, në mbledhjen e datës 19 qershor 2017 vendosi heqjen e licencave për shoqërinë “*Stock International Albania*” sh.a.

Për sa i përket mbikëqyrjes dhe rregullimit të tregut të sigurimeve, siç e thamë volumi i primeve të shkruara bruto nga shoqëritë e sigurimit rezultoi rreth 125 milionë euro, me një rritje prej 5,37% më shumë krahasuar me vitin 2016.

Sigurimi i detyrueshëm motorik zë pjesën kryesore në këtë treg, ndërkohë që totali i dëmeve të paguara është rritur me 15,8 %.

Kapitalet e shoqërive të sigurimit më 31.12.2017 kishin një rënie me 6,48% për shkak të mbartjes së disa problematikave, të cilat janë zgjidhur me masat korrektuese që ka marrë Autoriteti.

AMF-ja ka inspektuar shoqëritë e sigurimit me metodologjinë me bazë risku dhe masat e marra në total në tregun e shoqërive të sigurimit për vitin 2017, kanë qenë: urdhër për eliminim shkeljeje 2; plan masash për eliminim, 9; rekomandime për rritje kapitali, 4; revokim licence, 9; ndalim pagese të dividendit, 2; ndalim të dhënies së huave, 1; 5 vendime për fondin e kompensimit dhe 3 vendime për ndalim transaksionesh.

Janë marrë 5 vendime për sanksion me gjobë ndaj shoqërive të sigurimit dhe është sanksionuar një person përgjegjës për këto shkelje.

Siç e thashë, një ndër vendimet kryesore është ai për fondin e kompensimit. Për më shumë detaje për këtë çështje, do të flasë drejtori, zoti Koçi.

Ajo që kemi vendosur në planin afatshkurtër është auditimi i veprimtarisë së Byrosë Shqiptare të Sigurimit, një nga 4 kompanitë e njohura ndërkombëtare të shoqërive të auditit. Ne mendojmë se një plan skanimi i qartë dhe efikas do të na nxjerrë të gjithë problematikën, që ka ekzistuar ndër vite me fondin e kompensimit.

Për sa i përket mbikëqyrjes së tregut të pensioneve private, ky treg ka një rritje të madhe me 11,3%, por baza e nisjes është e tillë që do të kërkonte nisma të tjera të propozuara nga AMF-ja, që i kanë kaluar Ministrisë së Financave dhe shpresojmë që më pas të vijnë në Kuvend për të plotësuar zhvillimin e tregut të pensioneve private, gjë që do të plotësonte në fund të fundit, të gjithë reformën e pensioneve në Shqipëri. Totali i aseteve të këtij tregu është 1 miliardë e 727 milionë lekë për rreth 21 mijë persona, që sot kanë pensione private në Shqipëri.

Rritja vjetore për sa u përket aseteve është 31 % dhe 21%, për sa u përket numrit të personave të përfshirë në tregun e pensioneve private.

Projektet strategjike dhe rritja e kapaciteteve institucionale të AMF-së janë mbështetur edhe gjatë vitit 2017 nëpërmjet bashkëpunimit dhe marrëdhënieve efektive me institucionet ndërkombëtare, financiare dhe me donatorët. Kështu, gjatë vitit 2017, AMF ka

bashkëpunuar ngushtë me Bankën Botërore, Sekretariatën Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO), FSVC-në etj.

Një nga funksionet e bordit është kontrolli ndaj ekzekutivit dhe ne më së fundi, pas ndryshimeve që ndodhin në AMF në muajin prill 2017, kemi kompletuar njësinë e auditit të brendshëm me 3 persona, me një drejtues dhe me 2 auditues (njëri financiar dhe tjetri auditues IT-je). Njësia e auditit e plotësuar tashmë, po ndjek planin e veprimit për të dhënë masat përkatëse, të cilat duhen marrë parasysh nga AMF-ja.

Prioritetet për vitin 2018.

Në tregun e sigurimeve, besoj se do të shkojmë në drejtim të nxitjes së besueshmërisë së konsumatorit, nëpërmjet stabilizimit të tregut;

Në tregun e letrave me vlerë, AMF do të fokusohet në këto drejtime, në mënyrë që të ndihmojë zhvillimin e qëndrueshëm të këtij tregu: (i) eliminimi i kufizimeve që pengojnë zhvillimin e tregut; (ii) forcimi i funksionit të mbikëqyrjes; (iii) përshtatja dhe rregullorja e politikave të AMF-së në mënyrë që të lejohet krijimi i llojeve të tjera të fondeve; (iv) promovimi i tregjeve; (v) edukimi financiar; (vi) teknologjia.

Në tregun e pensioneve private vullnetare, AMF do të fokusohet në optimizmin e kuadrit fiskal, që rregullon këtë veprimtari.

Sa më lart, besoj se është një panoramë e përgjithshme e veprimtarisë së Autoritetit.

Me lejen tuaj, besoj se mund t'ia kaloj fjalën zotit Koçi, Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit, i cili do të japë një panoramë më të detajuar për sa i përket ndërtimit ekzekutiv të Autoritetit.

Faleminderit!

Ervin Koçi – Faleminderit!

I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar deputetë,

Në zbatim të detyrimit ligjor, ndodhem përpara jush për të prezantuar veprimtarinë e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për vitin 2017, si dhe problematikat, sfidat dhe objektivat për vitet e ardhshme.

Më lejoni që fillimisht t'ju falënderoj për kontributin tuaj dhe mbështetjen e vazhdueshme për të ndryshuar pozitivisht ecurinë e institucionit!

Gjatë vitit 2017 Autoriteti ka qenë tërësisht i angazhuar për të realizuar objektivin kryesor të tij, mbrojtjen e konsumatorit dhe të investitorit. Për realizimin e këtij objektiwi kaq të rëndësishëm kemi marrë në konsideratë dhe jemi mbështetur në problematikat e ngritura ndër vite nga Kuvendi i Shqipërisë nëpërmjet rezolutave përkatëse dhe vendimeve për

vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit. Jemi mbështetur, gjithashtu, në rekomandimet e dhëna nga institucionet partnere ndërkombëtare, një kërkesë kjo e pikës 10 e rezolutës së Kuvendit, si dhe nga institucionet publike, nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas rekomandimit të pikës 14 të rezolutës së Kuvendit, si dhe nga Autoriteti i Konkurrencës. I kemi vlerësuar të gjitha rekomandimet dhe kemi qenë tërësisht të angazhuar në zbatimin dhe integrimin e tyre në veprimtarinë tonë, duke u dhënë zgjidhje shumë problematikave të mbartura ndër vite.

Raportimin do ta fokusoj në tri drejtime kryesore:

Së pari, në forcimin e rolit mbikëqyrës të Autoritetit.

Së dyti, në ecurinë e tregjeve financiare në mbikëqyrje dhe veprimet e ndërmarra.

Së treti, në sfidat dhe objektivat për vitin 2018 dhe vitet në vazhdim.

Lidhur me drejtimin e parë, forcimin e rolit mbikëqyrës të Autoritetit, ky ka qenë një ndër prioritetet e institucionit për vitin 2017, duke u nisur edhe nga rekomandimet e dhëna si nga Kuvendi, ashtu edhe nga institucionet partnere ndërkombëtare për rikthimin në normalitet të funksionimit të institucionit, krijimin e marrëdhënieve bashkëpunuese dhe transparente ndërmjet strukturës ekzekutive dhe bordit, si dhe në forcimin e kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit.

Në funksion të forcimit të kapaciteteve mbikëqyrëse dhe në zbatim të rekomandimeve të konsulentëve të Bankës Botërore, bordi i Autoritetit miratoi strukturën e re organizative, si një domosdoshmëri për t'iu përgjigjur dinamikës së zhvillimit të tregjeve financiare jobankare.

Një risi është krijimi i strukturave të dedikuara sipas tregjeve nën mbikëqyrje, si dhe fokusimi te mbrojtja e konsumatorit.

Raportet e Bankës Botërore dhe misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar i kanë vlerësuar ndryshimet strukturore dhe rritjen e kapaciteteve mbikëqyrëse, si dhe funksionimin normal të institucionit dhe të bordit. Gjithashtu, progresraporti i fundit i Komisionit Europian, që propozoi hapjen e negociatave, ka vlerësuar arritjet e institucionit. Por, pavarësisht këtyre vlerësimeve, ne, si Autoritet, jemi të vetëdijshëm se ka ende mundësi për përmirësimin në drejtim të forcimit të kapaciteteve mbikëqyrëse për t'iu përgjigjur më së miri sfidave që ofrojnë proceset integruese në Bashkimin Europian.

Me strukturën e re i kushtohet një vëmendje e veçantë mbrojtjes së konsumatorit, duke krijuar një njësi të posaçme, e cila përfshin edhe edukimin financiar. Forcimi i kësaj strukture ishte i domosdoshëm për shqyrtimin dhe trajtimin e ankesave të konsumatorëve, në mënyrë sa më profesionale dhe të shpejtë, jo vetëm për mbrojtjen e tyre, por edhe për të

krijuar besimin e publikut tek tregjet financiare. Kjo rezultoi pozitive, pasi numri i ankesave u rrit ndjeshëm, gjë që tregon edhe rritjen e besimit të konsumatorit.

Në tremujorin e fundit të vitit të kaluar numri i ankesave ishte sa të gjitha ankesat e vitit 2016, ndërkohë që në tremujorin e parë të këtij viti numri i ankesave është pothuajse sa të gjitha ankesat e vitit 2017.

U plotësua njësia e Auditit dhe u përzgjedh nga bordi drejtues i njësisë; u miratua në bord Shoqëria e Auditimit të Jashtëm, duke realizuar kështu kërkesat e pikës 12 të rezolutës, si dhe u ndryshua rregullorja “Mbi marrëdhëniet e punës”, duke rritur kompetencat e bordit, një rekomandim ky i pikës 11 të rezolutës së Kuvendit.

Rritja e besimit të publikut tek Autoriteti dhe rritja e njohurive për këtë të fundit është një objektiv i veçantë për ne, pasi nga anketimet që kemi kryer rezultonte që publiku nuk e njihte ose kishte shumë pak informacion për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare. Në këtë kuadër, fuqizua rolin informues të Autoritetit, nëpërmjet të gjitha kanaleve medietike të komunikimit, në zbatim të pikës 8 të rezolutës së Kuvendit. Gjithashtu, gjatë vitit 2017 u riorganizua faqja zyrtare e Autoritetit dhe u zhvillua më tej komunikimi me qytetarin nëpërmjet rrjeteve sociale.

Një prioritet i rëndësishëm për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare në vitin 2017 ka qenë fuqizimi i rolit informues dhe edukimi i publikut në lidhje me funksionimin e tregjeve financiare jobankare. Kështu, Bordi i AMF-së miratoi strategjinë trevjeçare “Për rritjen e besimit të konsumatorit dhe të investitorit në tregjet nën mbikëqyrje”, si dhe planin e veprimit, zbatimin e të cilave filloi prej datës 1 tetor të vitit 2017, në zbatim edhe të pikave 6 dhe 8 të rezolutës së Kuvendit.

Një tjetër prioritet për vitin 2017, që lidhet me funksionimin e rolit mbikëqyrës, ka qenë përmirësimi i infrastrukturës së IT-së, ku vlen të theksohet se institucioni përballej me shumë problematika të mbartura në vite. Kështu, u konstatua se institucioni nuk e kishte sistemin *backup*, një risk shumë i madh për të humbur historikun e sigurimeve për çdo qytetar dhe të dhënat financiare të raportuara nga shoqëritë. Për ta zgjidhur këtë problem nënshkruam marrëveshjen me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë të Informacionit dhe tashmë jemi në fazën përfundimtare të instalimit të sistemit *backup*, duke shënuar kështu një arritje të rëndësishme të institucionit.

Në muajin tetor përfundoi hedhja në sistemin e ri të regjistrimit të dëmeve dhe të gjitha dosjeve të dëmeve nga viti 2008, duke përmirësuar infrastrukturën për implementimin e plotë të sistemit *bonus-malus*.

Viti 2017 shënoi, gjithashtu, edhe vitin e forcimit të marrëdhënieve bashkëpunuese me institucionet homologe të rajonit, partnerët ndërkombëtarë, që asistojnë në Shqipëri, si dhe organizatat ndërkombëtare ku aderohet, duke realizuar pikën 9 të rezolutës. Një sërë marrëveshesh u riaktivizuan në shërbim të shkëmbimit të informacionit, eksperiencës dhe praktikave më të mira për një mbikëqyrje efektive, si dhe u fuqizua bashkëpunimi me institucionet homologe të rajonit e më gjerë.

U zhvilluan një sërë takimesh me autoritetet homologe, si: Austria, Kosova, Maqedonia e të tjerë, ku shoqëritë tona operojnë në nivel grupi, për të shkëmbyer informacion për kompanitë e sigurimeve, që ushtrojnë aktivitetin e tyre në vendet përkatëse, si dhe shkëmbimin e eksperiencave pozitive. Po i përmend këto, pasi në pamje të parë duken si takime formale, por janë shumë të rëndësishëm, pasi mungesa e bashkëpunimit në vitet e kaluara, sidomos me Kosovën, ka sjellë problematika në disa shoqëri në tregun e sigurimeve, ku autoriteti po përballlet edhe sot.

Në kuadër të bashkëpunimit me institucionet ndërkombëtare, janë zhvilluar një sërë takimesh me përfaqësues të Bankës Botërore dhe përfaqësues të FMN-së, me përfaqësues të nivelit më të lartë të projektit SECO dhe organizmave të tjerë, që kanë përfaqësitë e tyre në Shqipëri, që kanë qenë jo vetëm në axhendën e partnerëve, por edhe nëpërmjet takimeve të kërkuara nga ana jonë. Ky bashkëpunim dhe asistenca e tyre ka qenë shumë i vlefshëm për aktivitetin e Autoritetit për vitin 2017.

Në vitin 2017 vijoi puna me projektet e asistencës teknike në funksion të forcimit të kapaciteteve mbikëqyrëse dhe rregullatore të AMF-së për tregjet që mbikëqyr, ku më kryesori mbetet projekti për forcimin e kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, të financuar nga SECO.

Gjatë vitit 2017 është kryer një punë intensive në kuadër të zbatimit të tri fazave të tij. Pas përfundimit të fazës së parë, po punohet për zbatimin e fazës së dytë, e cila konsiston në hartimin e drafteve fillestare të dy ligjeve, atij për fondet e investimeve dhe atij për tregun e titujve, si dhe ka filluar zbatimi i fazës së tretë të projektit lidhur me zhvillimin e kapaciteteve dhe trajnimet e stafit, që është edhe rekomandim i pikës 1 të rezolutës së Kuvendit.

Falë bashkëpunimit dhe marrëdhënies profesionale të Autoritetit me organizatat në të cilat aderohet, Shqipëria u përzgjodh, për herë të parë, nga Organizata Ndërkombëtare e Rregullatorëve të Pensioneve (IOPS), si vendi organizator i konferencës vjetore, e cila do të zhvillohet në Tiranë në vjeshtën e vitit 2019, që është edhe konferenca më e madhe financiare që është zhvilluar ndonjëherë në vendin tonë.

Gjithashtu, si rezultat i fuqizimit të marrëdhënieve dhe një roli tjetër se si Autoriteti i shikon marrëdhëniet me organizatat ndërkombëtare, muajin tjetër në Tiranë do të organizohet një takim rajonal me institucionet homologe për tregjet nën mbikëqyrje në tregun e sigurimeve.

Në muajin shtator Autoriteti European i Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale (EIOPA), në bashkëpunim me Bankën Botërore, do të organizojë për herë të parë në Shqipëri *workshop*-in ndërkombëtar me temë “Mbikëqyrja me bazë rrezikun”.

Në kuadër të aplikimit për projekte të reja, me përfitime për zhvillimin e tregut të sigurimeve, në gjysmën e dytë të vitit 2017 Shqipëria u përzgjodh si një nga katër vendet fituese për projektin e mikrosigurimeve “Akses në Iniciativën e Sigurimeve” (A2ii). Projekti synon të promovojë dhe të zhvillojë produkteve inovative për popullatën me të ardhura të ulëta, veçanërisht në fushën e bujqësisë, në biznesin e vogël e të tjerë, me synim rritjen e shkallës së përfshirjes së grupeve vulnerabël në skemat e sigurimit vullnetar me prime të ulëta.

Bashkëpunimi me rregullatorët ekonomikë dhe financiarë në vend është konsideruar mjaft i rëndësishëm për ecurinë e tregjeve financiare. Në funksion të këtij bashkëpunimi, janë fuqizuar marrëdhëniet me institucionet, veprimtaria e të cilëve lidhet ngushtësisht me aktivitetin mbikëqyrës apo rregullator.

Përveç bashkëpunimit të mirë me Bankën e Shqipërisë, në funksion të detyrave tona mbikëqyrëse dhe edukuese, kemi realizuar marrëveshje apo memorandume bashkëpunimi të reja me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve; me disa universitete në vend; me Institutin e Statistikave; me Agjencinë Kombëtare të Shoqërive të Informacionit, si dhe jemi në proces për ta nënshkruar marrëveshjen këtë muaj me Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Si detyrim edhe i rekomandimit të pikës 15 të rezolutës, kemi përmirësuar rregulloren për hartimin, miratimin dhe zbatimin e buxhetit, si dhe u rishikua një pjesë e tarifave.

Për të garantuar një mbikëqyrje efektive dhe në funksion të mbrojtjes konsumatore, Autoriteti ka përmirësuar kuadrin ligjor dhe rregullator, si dhe ka qenë i angazhuar në drejtim të forcimit të mbikëqyrjes, me orientim drejt mbikëqyrjes me bazë risku në tregjet nën mbikëqyrje.

Vlen të theksohet se Autoriteti ka punuar vetë për hartimin e projektligjit të ri “Për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve motorike”. Projektligji i paraqitur nga Autoriteti “Për disa ndryshime në ligjin “Për sigurimin e detyrueshëm””, në fund të vitit 2016, nuk u pranua nga Ministria e Financave për t’u shqyrtuar më tej. Ndaj, nisur nga kjo situatë, pas konsultave me grupet e interesit dhe me Ministrinë e Financave, si dhe pas sugjerimeve të dhëna nga

Banka Botërore, tashmë projektligji është dorëzuar në Ministrinë e Financave, duke realizuar edhe pikën 5 të rezolutës. Një kopje të projektligjit ju ka paraqitur sot edhe juve dhe miratimin e tij sa më shpejt do ta vlerësonim shumë, pasi ky ligj do të ndryshojë tërësisht funksionimin e tregut të sigurimit në vend, administrimin e një shoqërie sigurimi, sistemin *Bonus-Malus*, një kërkesë e kahershme e Komisionit të Ekonomisë dhe Financave, për më tepër është një detyrim që lind edhe nga progresraporti i fundit i BE-së.

I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar deputetë,

Vlen të theksoj se bordi i Autoritetit pas një pune 6 -muajore nga grupi këshillimor, ka miratuar strategjinë 5-vjeçare, me synim: zhvillimin e autoritetit dhe të tregjeve nën mbikëqyrje. Objektivi i kësaj strategjie 5-vjeçare është transformimi i tregjeve financiare jobankare nga tregjet më të dobëta, në tregje financiare më të konsoliduar të Ballkanit Perëndimor dhe do t'u paraprijë proceseve integruese të vendit tonë drejt BE-së.

Në funksion të zbatimit të strategjisë Autoriteti ka miratuar prioritetet e vitit 2018 dhe planin e veprimit të detajuar për çdo departament dhe ka filluar zbatimin e tij.

Sot ju kemi paraqitur strategjinë sintezë në planin e veprimit të vitit 2018. Strategjia e detajuar është shumë më voluminoze dhe përmban 72 rekomandime që ne i kemi kthyer në 72 prioritetet, të cilat janë objekt i punës sonë në 5 vjetët e ardhshëm.

Çështja e dytë që do të trajtoj në këtë fjalë është zhvillimi i tregjeve nën mbikëqyrje dhe veprimet e ndërmarra për të përmirësuar situatën.

Po e nis së pari me tregun e sigurimeve, duke shprehur që në fillim konstatimin se është tregu më problematik që kemi nën mbikëqyrje me probleme të mëdha strukturore, të trashëguara dhe të agravuara nga viti në vit si në funksionimin e tij ashtu edhe në marrëdhënien me konsumatorët. Ritmet e zhvillimit ndër vite të tregut të sigurimeve janë të fokusuara ende te produktet e detyrueshme, ndërsa zhvillimi i produkteve reale vullnetare është në nivele minimale. Në këtë treg ushtrojnë veprimtarinë e tyre 11 shoqëri sigurimi nga të cilat 8 në sigurimin e jo-jetës dhe 3 në sigurimin e jetës.

Arkëtimi i tregut të sigurimeve në vitin 2017 krahasuar me një vit më parë u rrit me rreth 4% ose 2% e GDP-së. Vendi ynë ka penetrimin e tregut të sigurimeve në raport me GDP-në më të ulët në Europë. Primet e shkruara bruto për tregun e sigurimeve në vitin 2017 rezultuan në vlerën 16,2 miliardë lekë, me një rritje prej 5,4

Erion Braçe – Drejtor, a ka mundësi të flisni më ngadalë që të kuptojnë edhe të tjerët se çfarë po thoni?

Ervin Koçi - Faleminderit, zoti kryetar!

....më shumë se një vit më parë, numri i kontratave për vitin 2017 arriti 1,235,092 me një rritje prej 9,7% krahasuar me një vit më parë. Primi i shkruar bruto për frymë është më i ulëti në Europë, pak më shumë se 5600 lekë ose 42 euro, ndërsa çmimi mesatar i një police sigurimi TPL u ul me 0,5% krahasuar me një vit më parë. Dëmet e paguara u rritën me rreth 16% krahasuar me vitin 2016, por raporti dëme- prime është ende në nivelin më të ulët, krahasuar me vendet e rajonit.

Tregu i sigurimeve ka ruajtur të njëjtin konfigurim të tregut shqiptar në vite, ku volumi i primeve të sigurimit të jo-jetës përbën 92% të totalit të primeve të tregut të sigurimeve, ndërsa volumi i primeve të sigurimit të jetës zë vetëm 7,5 %. Tregu i sigurimit të jetës vazhdon të jetë ende i brishtë.

Tregu i sigurimeve edhe gjatë vitit 2017 vazhdoi i orientuar drejt sigurimit të detyrueshëm, ku raporti ndërmjet sigurimeve të detyrueshme dhe atyre vullnetare rezultoi përkatësisht 61,5% dhe 38,5%.

Produktet vullnetare të sigurimit edhe pse quhen të tilla, vazhdojnë të jenë të lidhura vetëm me kërkesat e detyrueshme nga ana e institucioneve financiare, nga sigurimi i institucioneve publike që e kanë detyrim ligjor, si edhe nga disa kompani të huaja që e kanë në politikat e kompanisë “mëmë”.

Treguesit statistikorë të mësipërm japin panoramën se tregu i sigurimeve është i pazhvilluar dhe ka probleme strukturore. Mungesa e besimit të publiku, si edhe cilësia e qeverisjes kooperative e shoqërive të sigurimit, janë faktorë të rëndësishëm që kanë dhënë ndikimin e tyre në ecurinë e dobët të zhvillimit të tregut të sigurimit. Për të rritur besimin e publikut, veç të tjerave të përmendura më sipër Autoriteti ka arritur ndjeshëm masat mbikëqyrëse gjatë vitit 2017, si edhe i ka detyruar shoqëritë të rrisin transparencën me publikun. Për herë të parë të gjitha shoqëritë në faqen e tyre të *web-it* kanë të dhënat financiare të detajuara të aktivitetit të tyre.

Problematika më e madhe e këtij tregu është fondi i kompensimit, i trashëguar dhe i shtuar nga viti në vit, duke filluar nga viti 2002, por që është agravuar veçanërisht pas vitit 2014.

Autoriteti ka shqyrtuar dhe ka përdorur çdo hapësirë ligjore gjatë vitit 2017 për zgjidhjen e tyre, në funksion të respektimit të të drejtave të konsumatorëve, pasi ligji i miratuar “Për sigurimin e detyrueshëm” në vitin 2009 në funksionimin e Byrosë e ka të kufizuar ndikimin e Autoritetit, duke i dhënë më shumë kompetenca Asamblesë së Byrosë, që përbëhet nga drejtorët e Përgjithshëm të shoqërive. Autoriteti për herë të parë evidentoi

problematikat reale në lidhje me Byronë Shqiptare të Sigurimit, në veçanti për Fondin e Kompensimit, duke realizuar pikën 2 të rezolutës së Kuvendit.

Për këtë qëllim Autoriteti realizoi një inspektim pranë BSHS-së, për verifikimin e dosjeve të Fondit të Kompensimit, duke filluar nga viti 2002 e në vazhdim. Me përfundimin e këtij procesi Autoriteti arriti të krijojë një pasqyrë më të qartë të dosjeve të pashlyera dhe atyre në proces. Pas inspektimit Bordi në muajin tetor mori vendimin për një shtesë në Fondin e Kompensimit të vitit 2017 në vlerën 250 milionë lekë. Informacioni shërbeu për të marrë një vendim të qartë dhe të saktë në muajin dhjetor për detyrimet e prapambetura dhe fondin e kompensimit për vitin 2018, vendim që i jep zgjidhje përfundimtare problematikës së fondit të kompensimit, duke realizuar pikën 2 të rezolutës.

Të nderuar deputetë,

Kuvendi në këto vite nuk është informuar saktë për detyrimet dhe borxhet ndaj qytetarëve kanë qenë shumë herë më të larta, për më tepër të gjitha të paprovigjinuara nga shoqëritë. Në Kuvend është deklaruar nga raportimet vjetore se detyrimi është 1,3 miliardë lekë, por realisht detyrimi për vitet 2002 - 2013 ka qenë pak më shumë se mbi 3 miliardë lekë, ku shoqëritë kanë shlyer deri në fund të vitit 2017 rreth 1,8 miliardë lekë. Në diferencën prej më shumë se 1,2 miliardë lekë përfshihen edhe rreth 433 milionë lekë, ngjarje që janë në proces në gjykata, që nuk kanë ende një vendim të formës së prerë. Me vendimin e marrë nga Bordi në muajin dhjetor, këto do të provigjinohen nga shoqëritë, duke krijuar sigurinë e nevojshme për konsumatorin.

Gjithashtu prioritet është kryerja e pagesave të dëmeve të Fondit të Kompensimit për ngjarjet pas datës 1 janar 2014 e në vazhdim, me qëllim që mos të përsëritet fenomeni i akumulimit të tyre. Me situatën e konstatuar për vitin 2017, po përsëritej i njëjti fenomen si për vitet 2002 - 2013 me ngjarje të akumuluar dhe të papaguara apo në proces gjyqësor, si dhe të paprovigjinuara në vlerën 417 milionë lekë. Për këtë arsye janë zhvilluar inspektime në të gjitha shoqëritë e sigurimeve për praktikatat, objekt i Fondit të Kompensimit për ngjarjet e sigurimit nga viti 2014 e në vazhdim, ku janë verifikuar praktikatat e papaguara për këto ngjarje sigurimi, si dhe ka monitoruar plotësimin e detyrimeve nga shoqëritë, duke realizuar pikën 3 të rezolutës. Me vendimin e muajit dhjetor të Bordit, fenomeni i vitit 2002 - 2013 nuk mund të përsëritet dhe njëkohësisht pasqyron saktë aftësinë paguese të shoqërive.

Një nga kërkesat e rezolutës së Kuvendit ka qenë edhe verifikimi, veçanërisht për brokerat i algoritmit të serverit dhe sistemit të IT-së në lidhje me shitjet në të gjithë tregun për TPL, kartonin jeshil dhe Policinë Kufitare, me qëllim sigurimin e një konkurrence të lirë. U kryen të gjitha verifikimet e IP-ve në sistem. Në muajin nëntor të vitit 2017 u hoq IP-ja e

brokerit nga regjistri elektronik *online* i sigurimit të detyrueshëm motorik, pasi nuk bazohej në rregulloret e miratuara nga AMF-ja, duke realizuar pikën 4 të rezolutës së Kuvendit.

Një problematikë e trashëguar nga viti 2006, por që nuk është bërë prezent, është zbatimi i memorandumit të mirëkuptimit të lidhur midis Autoritetit të Bankës Qendrore të Kosovës dhe Byrosë Shqiptare të Sigurimi, e cila ka hyrë në fuqi që nga viti 2001 dhe është rishikuar në vitin 2006. Zbatimi i kësaj marrëveshjeje ka paraqitur problematika që lidhen me bllokimet e pagesave të dëmshpërblimit ndaj qytetarëve të dy shteteve, situatë, e cila po bëhet emergjente për shkak të rritjes së numrit të qytetarëve dhe vlerave të këtyre detyrimeve. Nisur nga ky fakt, me kërkesën tonë u zhvillua një takim zyrtar me përfaqësues të autoritetit homolog të Kosovës, Byrosë Kosovare dhe Byrosë Shqiptare të Sigurimit ku u diskutua lidhur me mbulimet e kontratave të sigurimit të detyrueshëm motorik, të cilat sipas legjislacionit të 2 vendeve nuk mbulojnë përgjegjësinë në territoret reciproke.

Në këtë situatë, për nevojën e përputhshmërisë ligjore të kontratës së sigurimit të detyrueshëm motorik dhe zbatimin reciprok, duhen ndryshime ligjore nga të dyja vendet ose një marrëveshje mirëkuptimi, e cila duhet të ratifikohet në parlament që të ketë fuqi ligjore. Për këtë problematikë kemi vënë zyrarisht në dijeni Kryeministrinë dhe Ministrinë e Financave.

Një problematikë tjetër në funksion të mbrojtjes konsumatore, besoj se është një rast unik, është konstatimi se koeficientët e përdorur për përlllogaritjet e vlerësimit të dëmeve shëndetësore i referoheshin një vendi tjetër, si Italia dhe i përkisnin vitit 1922. Këta koeficientë ishin llogaritur nga censusi i popullsisë italiane për periudhën 1901 – 1911, pra përpara 1 shekulli. Me përditësimin e të dhënave të fundit nga INSTAT-i pas marrëveshjes së nënshkruar në dhjetor, për herë të parë Autoriteti ndryshoi rregulloren duke llogaritur vetë koeficientët e rinj. Me përditësimin e koeficientëve, të dëmtuarit nga aksidentet do të marrin mbi 35% më shumë nga dëmet shëndetësore, një e drejtë, e cila u është mohuar deri tani.

Në mbrojtje të konsumatorit dhe formalizimit të tregut që nga datë 1 nëntor 2017 shitja e policave të sigurimit kufitar bëhet nëpërmjet raportimit të tyre në kohë reale përmes regjistrat elektronik të sigurimit të detyrueshëm motorik. Kjo masë rregullative siguron standardizimin e tregut të sigurimit për shitjen e të gjitha policave të sigurimit të detyrueshëm, si dhe eliminimin e rasteve të policave false, mosraportimit apo raportimit të pasaktë. Njëkohësisht u ndryshua rregullorja e BSHS-së, duke filluar nga data 1 janar e këtij viti, polica e sigurimit ka numër serial unik, duke hequr mundësinë që policat e sigurimit të një viti të mund të përdoren për vitet e mëvonshme, si dhe u standardizua procesi i

inventarizimit dhe asgjësimit të policave të papërdorura, duke kërkuar që të jetë e pranishme edhe administrata tatimore.

Një problematikë që mund t'i lindë tregut është nëse një shoqëri del nga tregu. Deri tani nuk jemi përballur me një situatë të tillë, por është rritur probabiliteti që në të ardhmen mund të ndodhë, për shkak edhe të detyrimeve të konsiderueshme të mbartura, objekt i fondit të kompensimit. Për këtë situatë ne nuk kemi një ligj të veçantë për të mbrojtur konsumatorin dhe jemi në kushtet kur duhet të ngremë një mekanizëm ligjor të kësaj natyre.

Gjatë vitit 2017, Autoriteti vijoi me inspektimin e plotë në vend në tre shoqëri të tjera sigurimi të jo-jetës duke përmbyllur kështu për tregun e jo-jetës, ciklin e parë të mbikëqyrjes sipas metodologjisë me fokus rrezikun, një rekomandim i lënë edhe në rezolutën e Kuvendit, duke realizuar pjesën tjetër të rekomandimit të pikës 1 të rezolutës.

Me rëndësi është fakti se Autoriteti ka në zbatim një paketë mbikëqyrjeje, e cila ndihmon procesin e vlerësimit dhe monitorimit të rreziqeve në kuadër të shoqërisë dhe të tregut në tërësi, duke rritur efektivitetin e procesit mbikëqyrës dhe marrjen e masave mbikëqyrëse.

Gjithashtu, gjatë vitit 2017 janë kryer edhe inspektime tematike në shoqëritë e sigurimit të jo-jetës dhe për herë të parë u ushtrua kontroll mbi agjentët ku autoriteti ka marrë masa administrative deri në pezullim të licencës për disa prej tyre.

AMF ka vijuar edhe në vitin 2017 kryerjen e inspektimeve të përbashkëta me institucione të tjera ligjzbatuese brenda dhe jashtë Shqipërisë, si me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave apo në inspektimin e përbashkët me Bankën Qendrore të Kosovës, pranë shoqërive të sigurimit që veprojnë në Kosovë, pjesë e shoqërive të sigurimit me qendër në Shqipëri.

Tregu i Fondeve të Investimit është një treg mjaft i rëndësishëm dhe është rritur në mënyrë të konsiderueshme nga viti 2012, duke zënë peshën më të madhe në tregjet nën mbikëqyrjen e Autoritetit. Afërsisht, sot është 4,8%, në raport me Prodhimin e Brendshëm Bruto, duke u shndërruar tashmë në një pjesë të rëndësishme të sektorit financiar në Shqipëri. Zhvillimi i këtij tregu reflekton qartë edhe interesin që kanë investitorët vendas për alternativa të reja investimi, përballë një mjedisi me norma të ulëta të interesit.

Asetet neto të tregut të fondeve të investimeve në vitin 2017 arritën në 72,7 miliardë lekë ose mbi 11%, krahasuar me vitin 2016. Numri i investitorëve është në 31,320. Ky treg dominohet kryesisht nga investimet në obligacione qeveritare brenda dhe jashtë vendit, të cilat përbëjnë 61.3% të aseteve të këtij tregu.

Vlen të theksohet se problematika në tregun e fondeve të investimit lidhet ngushtë me sfidat që shfaqen si rezultat i rritjes së konsiderueshme të këtij tregu, duke mbartur në vetvete edhe risk sistematik. Me qëllim përballimin e sfidave të këtij tregu, Autoriteti, së bashku me konsulentët e Bankës Botërore të projektit SECO, po shikon me prioritet përmirësimin e bazës ligjore dhe rregullative në drejtim të mbrojtjes së interesave të investitorëve dhe ndërhyrjes efikase dhe të shpejtë në raste kur kërkohet ndërhyrje nga rregullatori.

Gjithashtu, në funksion të mbrojtjes së investitorëve, Autoriteti miratoi ndryshime në Rregulloren përkatëse për shoqëritë administruese të fondeve të investimeve, duke eliminuar komisione apo tarifa që i ngarkoheshin investitorit pa të drejtë nga bankat depozitare.

Një zhvillim tjetër pozitiv përgjatë vitit 2017, ishte licencimi nga Autoriteti i depozitarit të dytë të fondeve të investimit, duke zbatuar kështu rekomandimin e dhënë nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, që e rrit konkurrencën në treg.

Kërkesa e investitorëve për alternativa të reja investimi po reflektohet edhe në shprehjen e interesit të shoqërive për krijimin e fondeve të reja të investimit, duke i dhënë hov më të lartë zhvillimit të këtij sektori. Në janar vitit 2018, Autoriteti licenoi edhe shoqërinë e tretë të menaxhimit të aseteve të fondeve të investimit.

Në aspektin mbikëqyrës, gjatë vitit 2017 u kryen inspektime në një prej Shoqërive Administruese, për të vlerësuar transparencën me klientët e Fondeve të Investimeve gjatë shitjes së produktit nga ana e shoqërisë administruese.

Një treg mjaft i rëndësishëm është edhe tregu i fondeve të pensioneve private. Për vitin 2017, tregu i pensioneve private ka shfaqur një tendencë në rritje, si për sa i përket numrit të kontribuesve si dhe totalit të aseteve neto, i cili u rrit me 21% në krahasim me fundin e vitit 2016. Politika e investimeve të tre fondeve të pensionit, të cilat operojnë në treg është afatgjatë, kryesisht në obligacione të thesarit të Republikës së Shqipërisë, që përbëjnë rreth 95% ndaj totalit të aseteve.

Me gjithë zhvillimet pozitive të këtij tregu, zgjerimi i mbulimit nëpërmjet rritjes së pjesëmarrjes së kontribuesve në këtë sistem, mbetet një ndër sfidat e Autoritetit. Vlen të theksohet se ky treg është ende në fazën fillestare. Aktivitetet e fondeve të pensioneve private janë vetëm 0.1% të GDP, niveli më ulët në Europë, në raport me GDP.

Rritja e ndërgjegjësimit të konsumatorit për të përfutur një pension shtesë nëpërmjet pensionit privat, është një faktor kyç që nxit zhvillimin e këtij tregu dhe është pjesë e strategjisë së Autoritetit për zhvillimin e tregjeve nën mbikëqyrje, por dhe që mund të zgjidhë problemet sociale për të ardhmen. Miratimi sa më shpejt i projektligjit, i cili është në

Ministrinë e Financave, do të sjellë iniciativa të reja, duke e bërë më atraktiv për publikun këtë investim.

Për një mbikëqyrje efektive të këtij tregu dhe për rritjen e besimit të investitorët, gjatë vitit 2017 ka vijuar zbatimi i metodologjisë së inspektimit me bazë risku, ku janë kryer inspektime në vend pranë njësive së depozitarit.

Një pjesë e rëndësishme e tregut që kemi nën mbikëqyrje është edhe Tregu i Kapitaleve. Deri tani tregu sekondar ka qenë i limituar në tregun me pakicë të letrave me vlerë, ku kanë mbizotëruar blerjet në tregun primar dhe shlyerjet e vlerës nominale në maturim. Për vitin 2017, transaksionet për “Blerje para afatit të maturimit” kanë qenë vetëm 4.5% e volumit të transaksioneve.

Krahasuar me vite më parë, interesi i kompanive për të emetuar letra me vlerë është rritur, edhe pse deri tani ka pasur zhvillime vetëm në drejtim të emetimit të obligacioneve me ofertë private për investitorët. Ky fakt përbën një sinjal pozitiv për mundësitë e zgjerimit dhe tregtimit të obligacioneve të shoqërive aksionare edhe në Bursë, që do të rrisë edhe transparencën. Bordi ka miratuar gjatë vitit 2017 prospektin për emetimin e obligacioneve të konvertueshme të një banke, dhe prospektin për emetimin e obligacioneve të një institucioni financiar mikrokredie.

Në lidhje me rritjen e transparencës për emetimin e Obligacioneve me ofertë private, në fillim të vitit 2018 autoriteti ka miratuar rregulloren mbi përmbajtjen e prospektit të obligacioneve, e cila kërkon një transparencë më të lartë nga kompanitë që emetojnë këto obligacione, sidomos në lidhje me investitorët individualë, një rekomandim edhe i pikës 7 të rezolutës së Kuvendit.

Interesi i shoqërive aksionare për të emetuar obligacione u reflektua edhe në licencimin si kujdestar të një bankë tjetër, duke e çuar në 3 numrin e kujdestarëve të obligacioneve të shoqërive aksionare.

Gjatë vitit 2017, në tregun e titujve janë licencuar edhe 3 shoqëri brokerimi, me fokus të aktivitetit si agjentë i brokerit të huaj, nën administrim të të cilëve janë platformat online përkatëse.

Mungesa e një tregu sekondar, i cili mundëson likuiditetin dhe vlerësimin e drejtë të portofolit të aseteve, ka qenë ndër vite një ndër problematikat më të mëdha në tregun e kapitaleve në Shqipëri, zhvillimi i të cilit vijon të jetë ende modest. Siç e përmendi edhe kryetari i bordit, një zhvillim pozitiv në tregun e kapitaleve në vend, ka qenë Licencimi i Bursës Shqiptare të Titujve, “ALSE”. Funksionimi i bursës krijon premisat për zhvillim të tregut të kapitalit, në drejtim të rritjes së transparencës, por edhe duke krijuar mjedisin e

përshtatshëm, që investitorëve tu jepen mundësi të reja investimi, duke rritur njëkohësisht edhe aksesin në burime të reja të kapitalit për biznesin shqiptar. Domosdoshmëria e licencimit të bursës lidhet edhe me funksionin e rëndësishëm të tregut sekondar, për të krijuar likuiditet dhe një vlerësim të drejtë të çmimit të titujve. Vendimi i Bordit të Autoritetit për licencimin e bursës erdhi pas një periudhe të gjatë të diskutimeve, konsultimeve, opinionit pozitiv nga Ministria e Financave, Grupi Këshillimor i Stabilitetit Financiar dhe Banka e Shqipërisë.

Që prej muajit shkurt 2018, bursa shqiptare e titujve ka filluar aktivitetin e saj, aktivitet ky që është kufizuar nga ana jonë vetëm në tregtimin e titujve të qeverisë së Republikës së Shqipërisë.

Autoriteti po tregohet i kujdesshëm për të monitoruar çdo veprim të bursës, për të ofruar transparencë maksimale për investitorët, ndërkohë që po i kushton vëmendje edhe bazës rregullatore të vetë Bursës, në mënyrë që të sigurohet dhe të ofrohet një treg, i cili të krijoj besim për të gjithë operatorët, një treg i drejtë dhe transparent.

Autoriteti po mbikëqyr me kujdes shoqëritë të cilat janë licencuar nga Autoriteti për të kryer veprimtarinë e agentit për llogari të shoqërive të huaja të brokerimit, që administrojnë platforma të tregtimit online. Janë zhvilluar inspektime pranë tyre përgjatë vitit 2017, dhe gjatë këtij muaji ne jemi në inspektim të përbashkët, së bashku me Drejtorinë e Parandalimit të Pastrimit të Parave.

Për subjekte që ushtrojnë aktivitet me platforma të palicencuara, i jemi drejtuar të gjithë institucioneve të shtetit: Shërbimit Informativ Shtetëror, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Drejtorisë së Parandalimit të Pastrimit të Parave, për të pasur një plan të përbashkët për të eliminuar këtë aktivitet të paligjshëm. Njëkohësisht, e kemi informuar publikun disa herë në lidhje me riskun e këtyre investimeve, duke realizuar edhe rekomandimin e pikës 7 të rezolutës.

Vlen të theksohet se pas inspektimeve në vend vitin e kaluar, Autoriteti konstatoi se një shoqëri në funksionin e saj si agent i brokerit të licencuar kishte problematika serioze dhe bordi i revokoi licencën.

Pjesa e tretë ka të bëjë me sfidat dhe objektivat për vitin 2018 e vitet në vazhdim.

Viti 2018 është shumë sfidues për Autoritetin, në lidhje me zbatimin e planit të veprimit të strategjisë e për hedhjen e themelit për transformimin e tregjeve financiare jobankare nga tregjet më të dobëta në tregjet financiare më të konsoliduara në Ballkanin Perëndimor.

Jo vetëm problematikat e përmendura gjatë fjalës janë objektivat e këtij viti, por do të jemi të angazhuar të punojmë edhe në drejtim të përgatitjes së infrastrukturës, në funksion të procesit integruar në Bashkimin Europian, konkretisht për zbatimin e SOLVENCY II në tregun e sigurimeve dhe MIFID II në tregun e kapitaleve.

Ne jemi tejet të angazhuar në drejtim të zhvillimit të sistemeve të teknologjisë së informacionit, ku do të synojmë përfshirjen e të gjitha tregjeve nën mbikëqyrje në një sistem të integruar (BI). Gjithashtu, synojmë të mbështesim dhe nxisim kalimin e sa me shumë shërbimeve të tregjeve në format e tyre elektronike dhe dematerializimin e produkteve.

Në drejtim të forcimit të kapaciteteve mbikëqyrëse, do të përgatisim një administratë sa më të aftë profesionalisht dhe të qëndrueshme në kohë, si dhe në drejtim të zbatimit me korrektësi të kuadrit ligjor dhe rregullator, me qëllim marrjen e masave për ruajtjen e shëndetit financiar të shoqërive në tregjet në mbikëqyrje të Autoritetit, për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm të tyre në funksion të mbrojtjes së interesave të konsumatorëve e investitorëve.

Duke synuar arritjen e objektivave për të zhvilluar tregjet financiare jobankare, ne do të kemi dhënë kontributin e duhur në rritjen ekonomike të vendit si dhe të punëdhënies.

Faleminderit, kryetar!

Erion Braçe - Fjalën e ka zonja Kushi, si relatore e komisionit për raportin vjetor të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

Evis Kushi – Faleminderit, kryetar!

Së pari, falënderoj kryetarin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe gjithë ekipin drejtues, për këtë pasqyrim të plotë të punës së këtij institucioni për vitin 2017.

Natyrisht që puna gjatë vitit 2017 ka pasur rezultate pozitive, arritje dhe suksese, por nga ana tjetër ka edhe disa drejtime, problematika për të cilat duhet punuar akoma më shumë në të ardhmen në mënyrë që rezultatet të jenë edhe më të mira.

Për të mos përsëritur shumë nga detajet, që ju iu referuat në fjalën tuaj, do të ndalem shumë shkurt në disa konsiderata apo vlerësime dhe më gjatë do të ndalem te pjesa e rekomandimeve për punën tuaj në vazhdim.

Duke analizuar punën dhe raportin që ju prezantuat në komision, vlerësojmë cilësinë dhe masën e mbrojtjes së interesave të konsumatorëve dhe investitorëve të tregjeve të mbikëqyrura, si dhe përmirësimin e dukshëm të rolit mbikëqyrës në tregun e sigurimeve, si një treg që paraqet problematika të akumuluar prej vitesh dhe gjendjen e njëjtë pa problematika, të qenësishme në tregun e skemave të pensioneve vullnetare. Por ndërkohë

konstatojmë se ka mosshfrytëzim të të gjitha kapaciteteve dhe hapësirave ligjore për sa i takon tregut të titujve mbi kapitalin.

Gjithashtu, vlerësojmë rezultatet e arritura deri tani në hartimin e metodologjisë së mbikëqyrjes me fokus riskun për tregun e sigurimeve, synimet për krijimin e platformës bazë për tarifimin me bazë riskun, si dhe plotësimin e detyrimeve të shoqërive të sigurimit ndaj byrosë për pagesat e prapambetura.

Po ashtu vlerësojmë edhe nismat në rritje, për sa u takon subjekteve që tentojnë investimin në tituj mbi kapitalin; vëllimin në rritje të investimeve kolektive në skemat e investimit në tituj mbi kapitalin, si dhe nismat ligjore që po ndërmerren nga AMF-ja për hartimin e dy ligjeve bazë që rregullojnë investimin në tituj mbi kapitalin.

Ndërkohë, duke u bazuar në këto rezultate, në punën tuaj dhe në rezolutën që Kuvendi ka hartuar vitet e mëparshme ne rekomandojmë që Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të angazhohet më shumë në disa drejtime:

Së pari, të përmbyllen brenda vitit 2018 të gjitha inspektimet me fokus rrezikun dhe të hartohet një raport i qartë për rezultatet e këtyre inspektimeve në të gjitha shoqëritë e sigurimeve.

Së dyti, të hartohen skenarët e qartë për zgjidhjen e problematikave në lidhje me Byronë Shqiptare të Sigurimit dhe në përgjithësi për fondin e kontestimit, duke përfshirë identifikimin e nevojave për ndryshime të akteve ligjore dhe nënligjore dhe hartimin e amendamenteve përkatëse me objektiv respektimin e të drejtave dhe trajtimin e barabartë të investitorëve, me synim ndalimin e ripërtëritjes së situatave si të ato të kaluara. Amendimet e pritshme ligjore për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve motorike të sigurojnë zbatimin e masave stabilizuese në tregun e sigurimeve dhe vendosjen e standardeve të mirëpërcaktuara për rezervat minimale, nivelin e likuiditetit, mjaftueshmërisë së kapitalit, praktikave të provigjionimit dhe përmirësimin në masa të arsyeshme të raportit dëme-prime.

Së treti, pasi është përmbyllur procesi i verifikimit të algoritmit të serverit dhe sistemit të IT-së në lidhje me sistemin e shitjes së të gjithë tregut në përdorim të brokerit, i cilit tregtonte TPL dhe përfundimit të verifikimeve të IP-ve në sistem, që vijuan me mbylljen e të gjitha IP-ve, që rezultonin aktive dhe nuk bazoheshin në rregulloret e miratuara nga AMF-ja, rekomandojmë të merren masa për parandalimin e krijimit në të ardhmen të skemave të tilla për produktet e tjera të tregut të sigurimeve.

Së katërti, të bëhet auditimi i bazës së të dhënave të sistemeve dhe programeve aktualisht në përdorim të tregjeve të mbikëqyrura nga AMF, me qëllim evidentimin e

problematikave dhe përmirësimin e tyre në funksion të aksesit të lirë, të barabartë dhe sigurimit të investitorëve.

Së pesti, në funksion të inkurajimit dhe rritjes së besimit të konsumatorit në rolin e AMF-së të merren masa të posaçme të karakterit informues dhe edukues të publikut për investimin në tituj, në lidhje me riskun që mbartin këto lloj investimesh dhe veprimtaritë e palicencuara apo në kundërshtim me ligjin.

Pra, këto veprimtari të palicencuara apo në kundërshtim me ligjin të shoqërohen nga AMF-ja me vendimmarrje dhe reagime të shpejta dhe institucionale.

Së gjashti, të merren masat e duhura që ligjet e reja, që rregullojnë veprimtarinë e tregut të investimeve në tituj mbi kapitalin, të mos referojnë zbutje të kriterëve për licencim të subjekteve që kërkojnë të pajisen me licencë për ushtrim veprimtarie në tregun e titujve mbi kapitalin dhe as dobësim të kërkesave për transparencë. Kuadri i ri ligjor të synojë kufizim apo ndalim të zhvillimit të skemave të investimit jashtë tregjeve të licencuara, të paktën për një periudhë 5-vjeçare, si dhe një periudhë ndalimi 3 deri në 5-vjeçare të lejimit të skemave alternative të investimeve të njohura si skema spekulative me risk të lartë.

Së shtati, duke marrë në konsideratë zhvillimin e tregjeve dhe shtimin e subjekteve të licencuara brenda vitit 2018, të rishikohen tarifat që detyrohen të paguajnë subjektet e licencuara deri në masën që i nevojiten autoritetit për të siguruar vetëfinancimin.

Së fundi, në Rregulloret e Brendshme të Autoritetit të përshkruhet qartë nga njëra anë përgjegjësia e Autoritetit në raport me qendrën, për sa i takon hartimit të kurrikulave dhe nga ana tjetër mënyra e financimit të qendrës, duke respektuar dispozitat ligjore në fuqi, për sa i takon financimit dhe përdorimit të fondeve të autoritetit.

Si përfundim, duke e vlerësuar edhe një herë punën e bërë gjatë vitit 2017 të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare shpresojmë dhe besojmë që këto rekomandime, të cilat do të reflektohen pastaj edhe në pastaj në rezolutën që do të hartojë dhe do të miratojë Kuvendi i Shqipërisë, të merren në konsideratë nga ana juaj.

Faleminderit!

Erion Braçe – Faleminderit, zonja Kushi!

Natyrisht këto janë rekomandime fillestare, por besoj se komisioni ynë do t'i pasurojë këto rekomandime edhe me të tjera, të cilat do të dalin nga procesi i kontrollit i këtij komisioni mbi veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2017. Procesi do të vazhdojë javën tjetër me pyetje dhe natyrisht, edhe me përgjigje dhe më pas do të pasohet me diskutime të komisionit në raport me veprimtarinë e Autoritetit Mbikëqyrës për vitin 2017.

Mbledhja mbyllet këtu.

Do t'ju lutesha edhe një herë që deri në orën 16:00, anëtarët e komisionit që kanë pyetje për t'i adresuar Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare t'i depozitojnë ato pranë sekretarisë dhe ditën e martë të javës tjetër, në orën 10:00, do të jemi këtu për të marrë përgjigje për pyetjet e adresuara Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA